

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Besmir Beja i Doganave rrit taksën e zhdoganimit të makinave me urdhër të brendshëm - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/besmir-beja-i-doganave-rrit-taksen-e-zhdoganimit-te-makinave-me-urdher-te-brendshem/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 14:46:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 14:36:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	530ca65c02b3caf8bb510ca7b579c0f0a3138769548544b3a684f48724f8dbd8
TEKSTI	59d26a47c6c5454e757073f21a9d8f146328bfe8480e75bad862118c4b35f8d2
PAMJA	e541430265b9024d59289a7a64dd4a0666c9ce13edd1d7d517725283510aca77

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e0296809f0d9667c784110b135250b6ff42cf15c03c36cceeafb775eec4647eb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e0296809f0d9667c784110b135250b6ff42cf15c03c36cceeafb775eec4647eb>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Besmir Beja i Doganave rrit taksën e zhdoganimit të makinave me urdhër të brendshëm

by Lajm Lajm — September 16, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Një urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, Besmir Beja, rrit deri në 20 për qind taksën që qytetarët shqiptarë do të paguajnë në dogana kur importojnë automjete nga jashtë.

Ndonëse urdhri nuk prek shkallën e taksës, ai rrit bazën e taksueshme dhe rrjedhimisht edhe detyrimin e TVSH-së që qytetarët duhet të paguajnë në doganë.

Urdhri i Bejes që rrit taksën e zhdoganimit të automjeteve

Bëhet fjalë për zhdoganimin e automjeteve, në rastet kur nuk pranohet çmimi i transaksionit i paraqitur nga qytetari dhe doganieri përdor metodat alternative të vlerësimit të çmimit. Deri më sot, përcaktimi i vlerës së një automjeti, kur dogana nuk pranon çmimin e transaksionit është bazuar në një udhëzim të vitit 2018 të ministrit të Financave.

Sipas këtij udhëzimi, kur nuk pranohet çmimi i referencës, dogana përdor si burim informacioni tre faqe të specializuara, në varësi të origjinës. Për automjetet që importohen nga vendet e Bashkimit Europian, referenca është revista Quattroruote.

Në nenin 17, udhëzimi përcakton se "vlera e një autoveture gjendet në tabelën "Quattroruote", duke u nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast, vlera e automjetit nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit që gjendet në tabelë." Por një urdhër i nxjerr nga Besmir Beja një javë më parë e përmbys totalisht këtë formulë. Sipas urdhrit të Bejes, referenca për çmimin e zhdoganimit do të nxirret nga mesatarja e tre faqeve të specializuara, pa zbritjen 80 për qind që parashikonte udhëzimi i ministrit të Financave.

TË FUNDIT

Besmir Beja i Doganave rrit taksën e zhdoganimit të makinave me urdhër të brendshëm

SEPTEMBER 16, 2026

PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi të miratojë rezolutën për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë

SEPTEMBER 16, 2026

Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I padrejtë, askush se njollos dot luftën e shqiptarëve për liri

SEPTEMBER 16, 2026

A shuhet dënimi i ish luftëtarëve të UÇK-së duke shkruar Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë?

SEPTEMBER 16, 2026

Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/ Kryegjykatësi Smith tregon me detaje rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit

SEPTEMBER 16, 2026

Dokumenti/ Publikohet aktgjykimi i plotë për ish-krerët e UÇK-së

SEPTEMBER 16, 2026

Qeveria tërhiqet sërish, rikthen Bordin e Transparencës pas rritjes së naftës

SEPTEMBER 16, 2026

Dënimi i ish-krerëve të UÇK, turma nga sheshet e Prishtinës niset drejt EULEX-it

SEPTEMBER 16, 2026

"Jo në emrin tim"/ Policia holandeze arreston disa mbështetës

SEPTEMBER 16, 2026

Dënimet e Hagës/ Çfarë ndodh tani me ish-krerët e UÇK-së?

SEPTEMBER 16, 2026

Urdhri i Besmir Bejes qe rit taksen

Kjo është një marrëzi, ku praktikisht me një urdhër të brendshëm të drejtorit të Doganave, rriten taksa, një të drejtë që e ka vetëm Parlamenti me ligj.

Sa rritet taksa

Sipas shembullit që jep vetë urdhri i Besmir Bejes, për një automjet të cilit i korrespondojnë vlerat 18 900 euro, 19 300 euro dhe 19 100 euro në tre platforma të ndryshe, vlera e zhdoganimit llogaritet si mesatare e tyre. Pra, $18\,900\text{ €} + 19\,300\text{ €} + 19\,100\text{ €} = 19,100\text{ €}$.

Sipas logjikës së rregullit të vjetër, 80% e 19,300 € do të ishte 15,440 €. Me urdhrin e Bejes vlera orientuese behet 19,100 €. Pra kemi një diferencë prej 3,660 eurosh ose rreth 23.7% më shumë në bazën e vlerësimit. Mbi këto baze llogariten detyrimet perkatese.

Vetëm për tatimin mbi vlerën e shtuar, qytetari që në këtë rast do të paguajë 732 euro taksë shtesë për zhdoganimin e automjetit.

Referenca bëhet standard

Urdhri i Bejes ka edhe një problem më themelor. Sipas rregullit të vjetër, të përcaktuar nga udhëzimi i ministrit të Financave, burimet e jashtme përdorshin vetëm kur nuk pranohej vlera e transaksionit dhe nuk mund të përdorshin metodat e tjera të vlerësimit.

Urdhri i Bejesë vendos kërkimin në burime si pjesë standarde të procedurës për çdo automjet.

Pra, ajo që ishte një metodë rezervë rrezikon të jetë metoda standarde e vlerësimit të çmimit të zhdoganimit.

Manuali i ri i Doganës praktikisht kalon nga një sistem i standardizuar vlerësimi në një sistem me shumë diskrecion të doganierit, duke krijuar mundësinë që vlera doganore të jetë ndjeshëm më e lartë se çmimi real i blerjes së automjetit.

Ky urdhër bie qartazi ndesh me udhëzimin e Ministrit të Financave dhe praktikisht ndryshon bazën e taksimit. Kjo është rritje e taksave pa ligj, vetëm me një urdhër të drejtorit të Doganës. /Kapitali.al

Tags: besmir beja dogana takse zhdoganimi

Previous Post

PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi të miratojë rezolutën për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë



Lajm Lajm


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencë dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën
gjatë punës në Belsh nuk kishte
asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rogozhinë,
arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-
vjeçarin

0 SHARES



Qeveria premton rritje pensionesh në prag të
zgjedhjeve vendore

0 SHARES